



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E DERRREGULLIMIT, LEJEVE, LIÇENSAVE DHE MONITORIMIT

Nr. 1110 prot.

Tiranë, më 26.12.2018

Lënda: Dërgohen modelet e çertifikatave shëndetësore, veterinare dhe fitosanitare për produktet me origjinë shtazore, jo shtazore, produktet bimore dhe kafshët e gjalla që do të shoqërojnë ngarkesat gjatë importit, eksportit dhe tranzitit, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës

Z. AGIM ISMAILI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Tiranë

I nderuar Z. Ismaili,

Mbështetur në Protokollin për bashkëpunimin teknik në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës për njohjen bilaterale të çertifikatave veterinare dhe produkteve me origjinë shtazore dhe jo shtazore, nënshkruar në Prishtinë, më 16.11.2012, me qëllim lehtësimin e procedurave të eksport – importit dhe tranzitit midis të dy vendeve, në mbledhjen e përbashkët të dy Qeverive në Pejë, më 26.11.2018, u nënshkrua Protokollin ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës për njohjen bilaterale dhe unifikimin e modeleve të çertifikatave shëndetësore, veterinare dhe fitosanitare që do të shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produktet bimore gjatë importit, eksportit dhe tranzitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Bashkëlidhur gjeni për zbatim modelet e çertifikave shëndetësore, veterinarë dhe fitosanitare për produktet me origjinë shtazore, jo shtazore, produktet bimore dhe kafshët e gjalla që do të shoqerojnë ngarkesat gjatë importit, eksportit dhe tranzitit, të njohura midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Gjithashtu, modelet e çertifikatave të lart përmendura të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKU-së.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Aurora Alimadhi

